

ÃželÃ«sat e njÃ« martese tÃ« Suksesshme

Kontribuar nga Samir Abu Hamza
Sunday, 14 February 2010

Rëndësia e Martesës në Islam Shumica e myslimaneve nuk i din të drejtat e burrit apo të drejtat e gruas , Allahu (s.v.t) na ka urdhëruar që ta adhurojmë Atë ,dhe që ta pasojmë Muhamedin (s.a.v.s)
Njeriun më të dashur që Allahu (s.v.t)na ka urdhëruar që ta pasojmë është Muhamedi (s.a.v.s.).
Shumica mendojnë se pasimi i Muhamedit (s.a.v.s) përfundon me lutjet dhe kryerjen e haxhit por nuk është e mjaftueshme ,Allahu (s.v.t) ka thënë se Muhamedi (s.a.v.s) është shembull në të gjitha në vuajtje ,në mënyrën e sjelljes me grat e tije , me fëmijët , me pabesimtarët , me të nevojshmit dhe në marrëdhënie me Allahun (s.v.t) ,kështu që nëse e duam Allahun (s.v.t) e pasojmë Pejgamberin që është i dërguar për gjithë njerëzimin të na udhëzoj nga errësira në dritë me dëshirë e Allahut (s.v.t) .

Rëndësia e martesës në Shoqëri

Shoqëria perëndimore ka ndikuar shumë tek myslimanët , shumë vëllezër dhe motra myslimane nuk e kuptojnë rrezikun nga ndarja e partnerit dhe në një mënyre shumë të thjesht kërkojnë shkurorëzim duke mos e ditur se mund të jetë shumë fatal posaçërisht në sheqerin ku shumë vështir mund të kontrollojnë fëmijët ku prindërit nuk janë në dijeni për veprat e tyre . Kam zgjedhur këtë teme se nëse nuk jemi në gjendje të silllemi mirë me bashkëshortet tona do të kemi shumë probleme . Allahu (s.v.t) ka thënë ;" Dhe në mesin e shenjave të Allahut s.v.t Allahu ka krijuar nga ju palën që të gjeni prehje dhe qetësi në mes jush ."

Kjo është lidhja që duhet të jetë në mes gruas dhe burrit .Islami na inkurajon që të martohemi.

Muhamedi (s.a.v.s) ka thënë : " Oj rini kush është i afte të martohet ,martohuni . Aftësitë që janë kërkuar që ti posedoj një i ri për martës janë ato fizike dhe ekonomike . Martesa ju largon nga haremet në mënyre fizike dhe psikologjike .

Dhe nëse nuk jeni të aftë atëherë agjëroni sepse agjërimi është mburojë nga haremet .

kështu që Muhamedi (s.a.v.s) ju inkurajon që të martoheni.

Gjithashtu ka thënë se gruaja martohet për katër gjëra :Për familje , për pasuri , disa martohen për bukurin ,është e bukur por fatkeqësisht nuk ka njohuri për islam in e Muhamedi (s.a.v.s) ka thënë e disa martohen për dinë (fe) atëherë mbi të gjitha martohu me atë që ka fenë se përndryshe do të jesh humbës ,e kur të ketë fenë nuk është asgjë kundër nëse i ka edhe të tjerat karakteristika që Muhamedi (s.a.v.s) i ka përmendur .

Vëllezër dhe motra asnjëri nga ne nuk është i plotë pa partnerin tonë për atë edhe Allahu (s.v.t) na ka krijuar ,Ne kemi nevojë për njëri tjetrin Allahu (s.v.t) ka thënë "Ju jeni veshje për to edhe ato janë veshje për ju; ato janë mbulesa juaj edhe ju jeni mbulesa për to "

Muhamedi (s.a.v.s) na ka urdhëruar që të martohemi dhe ka thënë se do të jem krenar me ju në Ditën e Gjykimit .

Allahu (s.v.t) nga mëshira e Tij mbi njëzimin na ka dhuruar partnerin .

Muhamedi (s.a.v.s) ka thënë : "Gruaja është partneri i burrit dhe kanë të drejta aq sa ju ."

Këshilla për Prindërit në Islam

Muhamedi (s.a.v.s) i ka paralajmëruar prindërit , kushdo që vjen tek ju për të kërkuar vajzën tuaj dhe jeni të kënaqur me karakterin dhe fenë e tij pranojeni ofertën e tij se nëse nuk do të pranoni do të ketë shkatërrime në toke . Prindër nuk keni të drejt të thanit se e mohoj këtë njeri sepse është nga një Shtet tjetër nuk keni të drejt përderisa ai njeri i ka këto dy veçori dhe vajza e juaja e pranon atë atëherë pranojeni edhe ju . Karakteri është pjesë e fesë .

Për çfarë arsye Muhamedi (s.a.v.s) i ka cekur karakterin dhe fenë sepse disa do të mësojnë Kur'anin por nuk do të punojnë sipas tij.

Muhamedi (s.a.v.s) ka thënë shumë njerëz do të lexojnë Kur'anin , por Kur'ani do ti mallkoj sepse nuk punojnë sipas saj që gjendet në Kur'an . Për këtë arsye Muhamedi (s.a.v.s) ka thënë me të mirët ndër ju janë ata që janë më të mirë me grat e tyre dhe unë jam më i miri për grat e mija .

Në hutben e tij Lamtumirës Muhamedi (s.a.v.s) ka thënë : "Silluni mirë me gratë" .

Njëherë është pyetur Muhamedi (s.a.v.s) . Kush është personi më i dashur për ty ?

Është përgjigjur Aisha (r.a), një grua ,gruaja e tij , nuk ka qenë i turpëruar për këtë , pastaj është pyetur po nga burrat , Babai i saj , Ebu Beker (r.a) .

Vëllezër mos u turpëroni të thoni se e dua gruan time . Atë që e duam ka qenë i sinqertë edhe ka thënë se është Aisha (r.a) .

Karakterit ka shumë rëndësi në marrëveshjen e martesës .

Ligjet dhe kushtet e martesës në Islam

Ka kushte dhe ligje të martesës , është obligim për ata që janë të aftë fizikisht dhe materialisht dhe që frikohen se do të kryen ndonjë mëkat . Nëse i keni këto karakteristika atëherë është e obligueshme martesa për ju.

Kushtet e martesës :së pari duhet që ti jepet mehri gruas ,së dyti pëlqimi i përcjellësit që është babai i vajzës .

Muhamedi (s.a.v.s) ka thënë : " Nuk ka martesë pa pëlqimin e përcjellësit", gjithashtu ka thënë që çdo grua që martohet pa pëlqimin e prindit martesë nuk është e vlefshme , nuk është e vlefshme , mund të thuani pse , sepse Allahu (s.v.t) ja ka dhënë të drejtën Babait ,sepse ai mund të pyes për këtë djalosh , ajo mund të jetë shumë e dashuruar pas tij dhe nuk do të pyes edhe aqë . Kështu që, Islami i ka dhënë të drejtën babait që të përkujdesët për të dhe të pyes , mund të jetë gënjeshtar , të merret me droge , hajdut e gjera të tjera për këtë kjo është obligim dhe kusht për prindin .Gjithashtu dhe pëlqimi burrit dhe gruas .

Babai nuk ka të drejt që me forcë ta martoj te bijën , është një traditë që disa njerëz e kanë por islami është i pastër nga kjo . Në kohën e Muhamedit (s.a.v.s) një grua erdhi tek Pejgamberi dhe i tha : " Se babai e ka martuar pa pëlqimin e saj , kështu që Muhamedi (s.a.v.s) i dha asaj dy zgjedhje , mund të vazhdosh me këtë lidhje , apo të kërkosh ndarje .Gjithashtu është e pëlqyer që të jepet dhuratë jo nënës apo babait por gruas ku në disa vende dhuratën e marrin prindërit .

Muhamedi (s.a.v.s) ka thënë : " Mehri më i mirë është ai që është i thjeshtë "

Disa nga prindërit kërkojnë diç që është e pamundur të arrihet nga një djalosh i ri , keni frik Allahun dhe mos kërkon shumë , duke e mbajtur vajzën për aqë kohe , vajza mundet edhe të mbetet tek prindërit.

Dhe çfarë e thyen besimin e një gruaje apo burri është kur nuk kanë partner .

Një Drejtor në spitalin e Egjiptit të quajtur " Al-Mamura " ka thënë se shumica prej tyre që gjenden në spitalin psikiatrik janë ata që jetojnë vetëm nuk kanë partner .

Të gjithë e dimë këtë se nëse jeton vetëm e ndjen se diçka po të mungon në jetë , kjo është mëshirë nga Allahu (s.v.t) , që na ka dhuruar bashkëshorte .

Dhe kur të martoheni publikojeni ,informoni njerëzit kështu që më vonë njerëzit nuk do të flasin për ju .

Si mundet Burri ta fitoj dashurin e gruas së tij ?

Së pari mbani në mend se gruaja është person shumë i butë,duhet që ti afroheni në mënyrë të butë me të . Gruas i pëlqen që burri të jetë i drejt me të e të mos i tejkaloj normat. Gjithashtu i pëlqen që kur rregullohet për burrin e saj , ta marr komplemente të thuash MashAllah po dukesh shumë mirë , edhe nëse nuk është e vërtet ,gruas i pëlqen të dëgjoj fjalë të mira nga burri , duke falënderuar Allahun dhe duke i thënë se nuk mundem të jetoj pa ty jepni komplemente të tilla .

Gruas nuk i pëlqen kur përmendeni një grua tjetër , ajo grua na ftoj për dark dhe po gatuante shumë mirë ,kujdes nga kjo sepse mund të ndikoj dëmshme në martesën tuaj.

Gruas nuk i pëlqen kur burri e kërcënon me shkurorëzim , nëse e thua këtë do të shkurorëzoh nëse e bën këtë do të shkurorëzoh mos ja thuani asnjëherë një gjë të tillë.

Gjithashtu mos e përdorni dhunën në gruan tuaj .Muhamedi (s.a.v.s) i ka mallkuar ata që i godasin grat e tyre në fytyrë .

Allahu (s.v.t) në Kur'an ka thënë ,: "Se pari këshilloni , nëse nuk përmirësohen largoni nga shtrati ,por edhe nëse nga kjo nuk ka dobi atëherë goditeni (me drurin e misvakut lehtë) .Nuk keni të drejt që ti mavijoseni apo gjakosni është haram ta bëni një gjë të tillë keni frik Allahun (s.v.t.) mos i shkaktoni dëm gruas tuaj .

Çka nuk i pëlqen Gruas ?

Kur ajo vepron diç dhe burri qesh me veprën e saj ,(p.sh) lexon diç nga Kur'ani dhe burri ia kthen ,eh e sheh se nuk din të lexosh .Mos e bëni këtë .Dhe kurrë mos e turpëroni në praninë e të tjerëve mos e thuaj këtë apo atë në praninë të prindërve të tu keni frik Allahun (s.v.t) .

Gruaja pëson disa ndryshime gjatë shtatzënisë dhe lehonisë kështu që silluni butë me të. Do ti këshilloja motrat që mos të dilni dhe ti tregoni motrave tjera se si kaloni me burrin tuaj e veçanërisht nënës tuaj , sepse nëna është shumë e ndjeshme. Po ti thuash babait do të thotë nuk është asgjë ajo unë i thoj të njëjtat gjëra nënës tënde , kthehu tek burri yt.

Për disa arsye më së miri është të flisni me burrin tuaj në kohën e duhur , jo në kohën kur kthehet nga puna është i lodhur i uritur dhe mos i thuani me zë të lartë : " Dua të flas me ty?! " , jo ju lutem gjeni kohën e duhur dhe provoni të flisni me një tonë të ulët . Kjo do të përmirësoj gjendjen tuaj .

Vëllezër provoni që të jeni sa më të pasur , Ebu Abas (r.a) ka thënë ; " Sikur që dua gruaja të zbukurohet për mua edhe unë do të zbukurohem për gruan time , dhe kështu duhet të jetë që të mbahet marrëdhënie e fortë ndërmjet jush .

Mos u largoni për kohë të gjatë nga gruaja e posaçërisht kur nuk keni fëmijë , kaloni sa më shumë kohë me të . Mos thuaj nuk e di pse ankohen unë kaloj mjaft kohë me të , tri apo katër orë mos mendoni ashtu sepse shumicën e kohës e kaloni duke shikuar TV ,por koha më e çmuar është kur bisedoni me të ,Si kalove sot ? Çka bëre ? Çfarë ke Gatuar ?

Problemi më i madh në marrëdhënie bashkëshortore është sepse kanë mungesa të komunikimit .

Gjithashtu dilni së bashku nga shtëpia që të jeni vetëm me njëri tjetrin , por fatkeqësisht jetojmë me një shoqëri që bashkëshortët nuk kanë shumë kohë për asgjë .

Si mundet gruaja ta fitoj dashurin e burrit ?

Së pari mos u sillni sikur të është i zënë në burg jepni hapësirë ,shumë nga motrat e bëjnë një gjë të tillë ,lusim Allahun (s.v.t) që ti falë , shumica prej tyre bëjnë pyetje ,Ku shkove ?,Çfarë bëre ?, Në sa koha kthehesh ?, Me kë bisedove ? ,A je i sigurt ? Duhet që të ketë besim në mes burrit dhe gruas jepi hapësirë , lëre që të luaj futboll , të dal me shokë . Mos pyete gjithë herë ku je dhe ku po shkon ? ,sepse këto gjëra mund ta largojnë atë nga ti .Motër kurrë mos u anko e të thuash se fqinjët kanë këtë e atë kanë shtëpi e veturë e ti nuk ke asgjë , je e kënaqur me atë që Allahu (s.v.t) të ka furnizuar , provo të rregullosh jetën tënde .

Allahu (s.v.t) ka thënë ;"Gruaja është mbajtësja e Botës ."

Marrur nga youtube : Samir Abu Hamza

Përktheu nga Anglishtja :L.L.Hoxha

Opinionet e autorëve nuk paraqesin domosdoshmërisht edhe opinionin e; www.krenaria.com